



© Bujar Gashi Photography



© Arben Liapashitica

KOSOVO

the untold story...

WIDEN YOUR WORLD | **TURKISH AIRLINES**



© Arben Liapashitica

airtour
www.airtour.net

VIZITO KOSOVËN

Dita 1 - Prishtina (Kryeqyteti i Kosovës)

Pas mëngjesit bëhet takimi me grupin në hollë dhe nisja për një vizitë në Prishtinë. Biblioteka Kombëtare e Kosovës - paraqet një dizajn modern arkitektonikë. Statuja e Nënës Tereza - lindur Gonxhe Bojaxhiu (Humaniste shqiptare dhe fituese e çmimit të paqes Nobel 1979). Statuja e Gjergj Kastriot Skënderbeut - feudal shqiptare i shekullit 15 i cili luftoi për të mbrojtur vendin nga Perandoria Osmane për me shume se dy dekada. Parku Arkeologjik i Hapur - objekte nga periudha neolitike. Muzeu i Kosovës - ndërtuar nga austriakët për ushtrinë Turke më 1898, ka një koleksion të gjerë të objekteve arkeologjike dhe etnologjike, duke përfshirë Perëndeshën e Neolitit në Fron (4000BC) terakote.

Xhamia e Çarshisë - objekti më i vjetër në Prishtinë ndërtuar në shekullin e 15 nga sulltani Turk Bajazit. Ndërtesa e Akademisë - e stilit konak- shtëpi private e ndërtuar ne shekullin e 19 ne stilin e perandorisë Otomane. Sahat Kulla - 26 metra e larte e ndërtuar nga Jashar Pasha më 1764, Xhamia 'Fatih' - apo Xhamia Perandorake ndërtuar më 1461 nën Sulltanin Turk Mehmed Fatih II, Hamami i Madh - kompleks i ndërtuar në 1470 me një elegance prej 15 kube me vrima të vogla që lejon dritën të hyj brenda. Muzeu Etnografik - kompleks i Emin Gjikut është një ndërtesë shume e ruajtur mirë nga shekulli 18 dhe është i vetmi ndërtim origjinal i mbetur në zonën e pazarit të vjetër. Kompleksi është ndërtuar brenda katër temave kryesore qe paraqesin: lindjen, jetën, vdekjen dhe trashëgimin e paprekshme. Ju mund të shikoni artin popullore, mënyra e jetesës, martesën, veshjen popullore, dhe ritualet e vdekjes dhe kështu me radhë. Fjetja në Prishtinë.

Dita 2 - Periferia e Prishtinës - Gadime - Brezovica Mëngjesi dhe nisja.

Në kilometrin e 5 nga Prishtina ndodhet Mauzoleu i Sulltan Muratit - ndërtuar nga Sulltani Pajazit, vendi ku Sulltani Turk Murat ishte vrarë gjatë betejës së Kosovës të vitit 1389 ku forcat e koalicionit krishterë të Ballkanit luftuan kundër ushtrisë osmane, Monumenti për Heronjtë e Kosovës (në kujtim të betejës së vitit 1389). Disa kilometra nga Prishtina ndodhet Manastiri i Graçanicës - ndërtuar më 1321 objekt për fenë ortodokse. Udhëtimi vazhdon në Ulpianë - qytet i lashtë i ndërtuar në shekullin e 20 në kohën e sundimit të mbretit trojan (qyteti me i bukur i Dardanisë Ilire). Artikuj te gjetur si monedha, pjata qeramike, arme, stoli janë te ekspozuara në Muzeun e Kosovës. Udhëtimi vazhdon ne gërmadhat e Novobërdës (Novus Mons) shekulli XIV-XV, një kala mesjetare dhe metropol ne atë kohe. Argjendi i Novobërdës është i njohur me një një aliazh argjendi me 1/6-1/3 ari. Shpella e Mermerit në Gadime - 25 km nga Prishtina e cila përmban thesaret natyrore të cilat janë bërë nga stalaktitet dhe stalagmitet me kristale të veçantë dhe shtresat e mermerit me ngjyra. Ekskursion në drejtim të Ski qendrës Brezovica - malet e Sharrit janë malet më sfiduese për disiplinën e skijimit, gjithashtu për ecje, ngjitje dhe aktivitete tjera. Udhëtimi vazhdon në Prizren me një opsion për qëndrim gjatë natës në qendrën rekreative Prevallë.

Dita 3 - Prizren - Gjakovë

Mëngjesi. Nisja për në Prizren (5 km). Ura e Gurit - simbol osman i Prizrenit, i ndërtuar në 1534 nga Ali Beu. Hamami i Gazi Mehmet Pashës - banjë turke e ndërtuar në vitin 1534 - shekullin XVI e cila paraqet një vepër arkitektonike dhe kulturore.

Xhamia e Sinan Pashës - Xhamia më e shquar në Prizren, e ndërtuar më 1615, Shtëpia Muze e Lidhjes

Shqiptare të Prizrenit - është një nga vendet më historike në të cilën është mbajtur Lidhja e Prizrenit më 10 qershor 1878, ku patriotet shqiptare u mbledhën për të formuar një program politik, ushtarak e kulturor për mbrojtjen e trojeve shqiptare kundër perandorisë Osmane. Kalaja e Prizrenit - fortese e vjetër , e cila ka qene një vend për mbrojtje dhe strehim që nga koha parahistorike. Katedralja e Zonjës së Përdetshme - Kishe katolike e ndërtuar me 1870 e veshur me mermer ku mbi derë ka një përshkrim për heroin mesjetar shqiptarë Skënderbeun. Tempulli i Shenjte Ljevish - daton qe nga shekulli 9 - 11 si një kishë bizantine me dizajn unik arkitektonik, i mbrojtur nga Trashëgimia Botërore UNESCO). Prizreni është i famshëm edhe për Filigran- zeje e lashtë që përdorë fije të holla ari dhe agjenti për të prodhuar dekore të bukura. Pjesa e vjetër e qyteti të Prizrenit është e rrethuar me shumë dyqane që shesin produkte të Filigranit, origjinale të bëra në Prizren.

Udhëtimi vazhdon në qytetin e Gjakovës (35 km). Gjatë udhëtimit me makinë vizitojmë Urën e Terzive - e shekullit 18, një urë e madhe prej guri me njëmbëdhjetë harqe -thuhet se ka qenë ndërtuar treqind vjet më parë nga rrobaqepësit e Gjakovës dhe të Prizrenit, si një hallkë shumë e rëndësishme për rrugë shumë strategjike të tregtisë e njohur si Egnatia (Rruga e ndërtuar nga romakët në shekullin e 2 p.e.s). Udhëtimi vazhdon duke vizituar një qendër tradicionale të vjetër tregtare në qendër të qytetit të Gjakovës si një arkitekturë të vjetër tradicionale e Kosovës, Xhamia e Hadumit - xhamia e famshme qe daton nga shekulli 16, Teqja Bektashiane - më mistike për Bektashi, vizita vazhdon ne shtëpinë feudale e vjetër tradicionale dhe ne Muzeun rajonal te Gjakovës - . mbledhjen e zanateve tradicionale dhe rrobave. Fjetja ne Gjakovë.

Dita 4 -Deçan - Pejë

Mëngjesi dhe nisja për Pejë në drejtim të Deçanit. Vizita për në Kullën e Haxhi Zekës në Isniq - e cila ndodhet në fund të Bjeshkëve të Nemuna në një distancë prej 12km nga Peja, shtëpi tradicionale shqiptare prej guri që daton në dekadat e fundit të trazirës së Perandorisë Osmane, Manastiri i Deçanit - ndërtuar në mes të vitit 1327 dhe 1335 nga mbreti serb mesjetar Shën Shtefan i Deçanit dhe ishte dedikuar për Ngritjen e Zotit. Manastiri është i vendosur në luginën piktoreske të Bistricës. Udhëtimi për tek manastiri i Patriarkales së Pejës - ajo mban shembuj të shquar të pikturave nga shekulli i 13 deri në shekullin e 17. Malet e Rugovës - aty mund të zbuloni natyrën sfiduese duke ecur, peshkuar, duke bere çiklizëm, alpinizëm dhe ngjitje. Dita përfundon me drekë tek Burimi - pishina më e madhe e peshqve trofta në Kosovë. Nisja për në Prishtinë.

VIZITA ME KËRKESË TË VEÇANTË:

Vizitë në bodrum-vere - Shijoni verën e famshëm të Kosovës me një traditë të gjatë që nga periudha ilire. Mësoni historinë e përgatitjes së verës në rajon, shijoni dhe ndani mendimin tuaj në 'Stone Castle' Punishte Vere. Ujëvara e Mirushes - Ajo është vendosur në brigjet e lumit të Mirushës, kaskadat midis liqeneve krijojnë ujëvara që kanë pamje të mahnitshme dhe paraqet një atraksion turistik të veçantë.

Udhëtim në këmbë 'Hiking' - Lugina e Rugovës (3-4 orë hiking me komunitetet lokale në Luginën e Rugovës) Malet Luboteni (Udhëtim në këmbë me udhëheqës përgjatë maleve Luboteni, drekë në afërsi të liqenit akullnajor Livadica, që gjendet 2.173 metra mbi nivelin e detit).

